

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Fillim Skoro dhe Have Haliti, anëtarë, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.L., nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.B. Sh. dhe mbrojtësit të akuzuarit av.A.K., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore–DKR në Prishtinë, P.nr.217/2007, të dt.11.01.2018, në seancën e mbajtur me datë 17.04.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e ankesës të mbrojtësit të akuzuarit S.L., e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet, aktgjykimi i Gjykatës Themelore–DKR në Prishtinë, P.nr.217/2007, të dt. 11.01.2018, dhe i akuzuari konform nenit 364 par.1 nën. par.1.3 të KPP-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

Se më datën 16.12.2006, rreth orës 19:00, në rrugën "...", në Prishtinë, hyrja 12, nr.12, i akuzuari S.L., shtënë me armë AK-47, të kal.7.62mm, të cilën e mbante pa autorizim 9herë në lartësi prej 50m, në banesën e të dëmtuarit B.L., ku dy vrima janë hyrëse në dritaren e dhomës të dëmtuarit, me qëllim të frikësimit dhe të kërcënimit pasi që më parë ishte martuar me vajzën e B., T., por në ndërkohë janë ndarë dhe ish bashkëshortja e të akuzuarit S.L., T. vajza e të dëmtuarit B., që ajo të kthehet së bashku me fëmijë, ndërsa shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

-me çka kishte me kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

II. Ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar B.L., hudhet poshtë si e pa lejuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore–DKR në Prishtinë, P.nr.217/2007, të dt.11.01.2018, i akuzuari S.L., është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, dhe për të njëjtën vepër është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj me 4(katër)këste, duke filluar me këstin e parë të pagesës, pas 15

ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kurse këstet tjera për çdo muaj, deri në pagesën e tërësishme të gjobës së shqiptuar.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK, do ta zëvendësoj me dënim burgu, duke ju llogaritur për një ditë burgimi nga 20Euro.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore që të paguaj shumën aq sa do të bëhet sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa i akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, me kohë kanë paraqitur ankesë:

Mbrojtësi i të akuzuarit S.L., av.A.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av.B.Sh., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshon vetëm për sa i përket dënimit të shqiptuar dhe të akuzuarit S.L., ti shqiptoj dënim më të rëndë si për nga llojit ashtu edhe për nga gjatësia.

Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.88/2018, të datës 28.02.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, të hudhet poshtë si e pa lejuar.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, seancën e ka mbajtur në mungesë të palëve për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme sipas ligjit për shkak se nuk bëhet fjalë për dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtëses të akuzuarit dhe në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP të Kosovës, si dhe të propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit, dhe gjeti:

Me aprovimin e ankesës, të mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi ndryshohet , dhe i akuzuari, lirohet nga akuza.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij, pretendon se gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet vendimtare, saktësinë e provave kundërthënëse. Procesverbalet mbi marrjen në pyetje në shqyrtimin gjyqësor nuk mund të përdoren si prova të drejtpërdrejta, me leximin e deklaratave të dëshmitarëve, B.L.,B.L. dhe Sh.L. dhe deklaratat e dëshmitarëve nuk kanë mund të lexohen, është propozuar që të merr në pyetje dëshmitarët dhe të ballafaqohen

drejtpërdrejt me të akuzuarin. Ankesa pretendon se është shkelur ligji penal me shpalljen fajtor të akuzuarit S.L., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, pa e specifikuar gjykata se me cilin kod i Akuzuari është shpallur fajtor, dhe nuk është zbatuar ligji më i favorshëm dhe se në çështjen penale neni 328 par.1 të KPK i cili ka qenë në fuqi, e cila vepër penale me kodin e ri është paraparë e në dispozitën ligjore të nenit 375 par.2 dhe gjykata nuk ka precizuar në aktgjykim bazën ligjore mbi të cilën të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe në këtë mënyrë është shkel të ligjit penal.

Ankesa pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejte dhe të plotë, përderisa në aktgjykim dëshmitari B.L., deklaron se me djalin B. dhe gruan Sh., kanë dëgjuar krismën nga automatike rreth orës 17:00, B.L., deklaron se është shkrepur rreth orës 18:16minuta, ndërsa dëshmitarja Sh.L., rreth orës 19:00, nga këto deklarata gjykata nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe të eliminoj kundërthëniet dhe në këtë mënyrë që të akuzuarin S., do ta lironte nga akuza. Gjukata nuk ka marr për bazë mbrojtjen e të akuzuarit se me dt.06.12.2006, ka qenë në shtëpinë e tij në fshatin ..., në rregullimin e oxhakëve të shtëpisë e që mund të vërtetohet nga fqinjët S., Q., M., B. e D. Përveç tjerash aktgjykimi mbështetet në mungesë e mjetit me të cilin është kryer vepra penale , akuza është ngritur pa asnjë provë materiale në të cilën do të bazohet edhe aktgjykimi dhe gjykata në arsyetimin e aktgjykimit thekson se e kanë parë të akuzuarin me automatike AK-47, në duar ku qëndronte poshtë banesës, ndërsa mjete me të cilin pretendohet se është kryer vepra penale, nuk është gjetur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, për të cilën është shpallur fajtor, e sipas Gjykatës së Apelit, në një gjendje të këtillë të përshkrimit të dispozitivit të aktgjykimit, lidhur me veprimet inkriminuese të përshkuara për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, nuk përputhet me veprimet e të akuzuarit dhe është në kundërshtim me provat e nxjerra nga shqyrtimi gjyqësor se i akuzuari S.L., me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit kishte shtënë me armë AK-47, në banesën e të dëmtuarit B.L., ku janë shkaktuar dy vrima hyrëse në dritaren e dhomës, e gjykata duke i besuar të dëmtuarve B.L., B.L., Shehide L., e në të cilat deklarate është mbështetur aktgjykimi ,si dhe në foto dokumentacionin e drejtorisë së teknikes kriminalistike dhe raporti i vendit të ngjarjes të dt.06.12.2006, ndërsa, fare nuk vlerëson mbrojtjen e të akuzuarit dhe deklaratat e dëshmitarëve I.L. dhe F.A., të dhënë me dt.13.02.2006 dhe me dt.06.12.2006, të cilët kanë deklaruar se i akuzuari ditën kritike ka qenë në fshatin Prekaz i pashtëm respektivisht se ka dëgjuar vetëm kërsim.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke i vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit, deklaratat e të dëmtuarve B.L., B.L. e Sh.L., ka ardhur në përfundim se provat në të cilat mbështetet aktgjykimi nuk kanë besueshmëri të lartë për shpalljen fajtor të akuzuarit S.L., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, e kjo mbështetet në atë se përveç foto dokumentacioni nga drejtoria kriminalistike dhe raportit të vendit të ngjarjes, nuk është gjetur pushka automatike AK-47, me të cilën është shkrepur me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit në banesën e të dëmtuarit B.L., ku janë shkaktuar dy vrima në dritaren e dhomës dhe aktgjykimi mbështetet se i akuzuari S.L., ka qenë i martuar me vajzën e të dëmtuarit B., T., me të cilën janë ndarë dhe të gjitha deklaratat e dëshmitarëve kanë të bëjnë me raportet bashkëshortore dhe asnjëri prej dëshmitarëve të cekur më lartë, nuk mund të vërtetojnë se e kanë parë të akuzuarin duke shkrepur me qëllim frikësimi dhe kërcëniimi në drejtim të banesës së dëmtuarit B.L. m ndërsa në vendin e ngjarjes dhe nga foto dokumentacioni nuk është gjetur pushka automatike AK-47 dhe gjykata aktgjykimin e mbështet në deklaratat e të dëmtuarve

, edhe pse asnjëri prej tyre nuk vërtetojnë se i akuzuari ka shkrepur me pushkën automatike AK-47, e të gjithë vërtetojnë se marrëdhëniet bashkëshortore nuk i kanë pasur të mira. Për më tepër dëshmitari I.L., si rezulton nga shkresat e lëndës deklaron se i akuzuari ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja me shkrepjen nga pushka automatike AK-47, i akuzuari S., e ka marrë veturën e tij, për të shkuar në Skenderaj dhe është kthyer në shtëpi rreth orës 20:00.

Gjykata e Apelit, me një besueshmëri të lartë, vlerëson se nuk është provuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, dhe sa herë që ekzistojnë mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve vendimtare ato interpretohen në favor të akuzuarit, e nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është gjetur pushka automatike AK-47 si mjet i kryerjes së veprës penale, me të cilën është shkrepur në banesën e të dëmtuarit B.L., për më tepër dëshmitarët e cekur më lartë, deklaratat e tyre i kanë dhënë për shkak të raporteve jo të mira bashkëshortore në mes të akuzuarit S. dhe bashkëshortes së tij T., dhe asnjëri prej dëshmitarëve nuk vërteton se e kanë parë të akuzuarin duke shkrepur me pushkën automatike AK-47, dhe nga provat ekzistuese të cilat gjenden në shkresat e lëndës Gjykata e Apelit, ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, dhe në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.B.Sh., është hudhur poshtë si e pa lejuar, për shkak se për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, paraqitja e ankesës është ekskluzivisht në kompetencë të prokurorit të shtetit, ndërsa i dëmtuari ka të drejtë në bazë të dispozitës së nenit 381 par.3 të ushtrij ankesë për veprën penale kundër jetës dhe trupit, integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzime të procedurës penale vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal dhe për këtë arsye gjykata ankesën e ka hudhur poshtë si të pa lejuar në bazë të nenit 400 për shkak se e njëjta nuk është e lejuar me ligj.

Si u cekë edhe më lartë, u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi konformë nenit 403 par 1 dhe 400 të KPP të Kosovës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.88/2018, të dt.17.04.2018

Procesmbajtësja,

Leonita Lajqi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i Kolegjit,

Xhevdet Abazi